



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

Procesverbal nga mbledhja e XXXVIII-të (tridhjetetë- mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 08 shtator 2025

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 10:05

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Demokrat Hodolli, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, znj.Fikmete Qurkolli, z.Selver Rama.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm tjerë ishin: z.Liman Zeqiri shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK; znj.Minire Zhitia zyrtare në Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Podujevës, përfaqësues nga KFOR Joel Razsas, Arianita Beqa Raci-UNMIK.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, theksoi, thirrja dhe materiali për këtë mbledhje besoj ju është dërguar me kohë.

Në vazhdim lexon rendin e ditës dhe pyet nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim.

Njëzëri me 9 vota Për nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në sallë, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 01.08.2025

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për ndonjë plotësim ndryshim apo vërejtje eventuale në këtë procesverbal nga mbledhja e kaluar, nëse jo e hedh në votim ashtu siç ju është përcjellë.

Pas votimit u konstatua se Njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin në sallë, miratohet procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete nga mbledhja e datës 01 gusht 2025, dhe atë sipas materialit të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

2. Informatë e Drejtoria e Arsimit për fillimin e vitit shkollor 2025/2026, gjendja aktuale e nxënësve të Komuniteteve jo shumicë sa i përket shkollimit, sfidat dhe vështirësitë.

z.Minire Zhitia, zyrtare në DKA, theksoi, të nderuar të pranishëm unë jam Minire Zhitia përfaqësuese nga Drejtoria e Arsimit, dua të theksoj që deri më tani nuk mund t'i sjellim sakt të dhënat e vitit të kaluar sepse kemi pak ditë që ka filluar viti i ri shkollor dhe nuk e kemi ende të përmblodhur një raport të detajuar se sa nxënës kanë filluar vitin e ri shkollor, mirëpo sipas të dhënave që i posedojmë ne si DKA në vitin e kaluar në shkollat fillore kanë qenë 104 nxënës të komunitetit jo shumicë, ndërsa në shkollat e mesme 11 nxënës, kështu që na nevojitet pak kohë që të përfundojmë raportin me qëllim që të kuptojmë se sa nxënës kanë filluar vitin e ri shkollor, sepse jemi ende në teren duke mbledhur të dhëna.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nxënësit e komunitetit jo shumicë, pra regjistrimi i nxënësve në klasën e I-rë dhe para shkollor edhe në shkollat e mesme pra klasën e X-të që është bërë regjistrimi i tyre, sa kam informata unë nga Lagjijaku jetojnë komunitetit jo shumicë në rr.“Ali Ajeti” të gjithë nxënësit që janë në moshë për regjistrimin e tyre në klasën e I-rë janë regjistruar.

Dua të theksoj se e kemi pasur një problem me vaksina ku na ka ndihmuar një drejtor dhe dua që ta falënderoj për ndihmën e tij sepse e kemi zgjedhur këtë problem dhe të gjithë fëmijët që kanë aplikuar për tu regjistruar në klasën e parë janë regjistruar. Sa i përket nxënësve të klasave të mesme, edhe ata janë regjistruar por jo të gjithë sepse ka disa që nuk janë regjistruar. Statistikën e këtyre në shkolla nuk e kam sepse e theksoi edhe parafolësja që është ende në proces sepse ka ndryshime dhe ndryshimet ndodhin gjithmonë, mirëpo për informata tjera e ftoj znj.Shkurte Sejdiu që të na informoj më gjerë se a ka nxënës të pa regjistruar në klasën e I-rë në Lagjen ku jeton ajo, pra a keni ndonjë informatë dhe a keni pas interesim për këtë punë.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, në lagjen ku jetoj unë rr.“Xhafer Meta” të gjithë fëmijët janë regjistruar në klasën e I-rë, dhe po ashtu ju informoj se unë i kam ndihmuar të gjithë të interesuarit që kanë pasë vështirësi për të aplikuar në e-Kosova për subvencionin e librave.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë prezentë këtu është përfaqësuesja e Drejtorisë së Arsimit, e ftoj që ta informoj drejtorin e DKA-së që nxënësit e klasës së mesme kanë problem për tekste shkollore dhe më kanë lajmëruar dhe informuar që nuk kanë mundësi t'i blejnë vetë, kështu që si Komunë gjithmonë nxënësve të shkollave të mesme i'u ka blerë librat, pra çdo herë Komuna e Podujevës e ka bërë furnizimin me libra për nxënësit e klasave të mesme të komuniteteve jo shumicë dhe jo vetëm. Mirëpo në vitin e kaluar nuk i kemi marr librat, prandaj kërkoj nga përfaqësuesja e Drejtorisë së Arsimit që është sot prezent në sall, që për këtë vit shkollor që kemi hyrë, të bëjë një kërkesë në Drejtori dhe të na jepet një përgjigje me qëllim që nxënësit mos të mbesin pa tekste shkollore, statistikën për këtë sigurisht se do e marrim sepse momentalisht nuk e kemi sa nxënës janë të komunitetit jo shumicë, mirëpo këtu mund t'i përfshijmë edhe një numër të nxënësve të komunitetit shumicë të cilët kanë një gjendje jo të mirë ekonomike.

znj.Minire Zhitia, zyrtare në DKA, theksoi, siç e kuptova parafolësin e nderuar, kërkesa e juaj është që Komuna të mundëson furnizimin me libra apo tekste shkollor për nxënësit e shkollave të mesme nga radhët e komunitetit jo shumicë duke përfshirë edhe një pjesë të nxënësve të komunitetit shumicë me kushte ë rënda ekonomike, sipas praktikave të kaluara siç e theksuat.

z.Liman Zeqiri, shëf i ZKKK në Komunën e Podujevës, theksoi, së pari përshëndes të gjithë të pranishmit që janë këtu sot dhe falënderoj edhe përfaqësuesen e DKA-së për informatat e dhëna.

Sa i përket çështjes së arsimit, është një temë delikate që ne duhet ta potencojmë me eksperiencën tonë që kemi vite me radhë ku kemi qenë në shërbim të atyre që kanë nevojë t'ju ndihmojmë, duke

potencuar atë fjalë që ata që kanë nevojë për të ndihmuar t'i ndihmojmë ne e kemi thënë në kuptimin edhe me të gjerë që janë edhe nga komuniteti shumicë dhe ata jo shumicë sepse nuk kemi bërë ndarje. Siç e theksove i nderuari Kryesues, në të kaluarën ka qenë praktikë e jona që t'i ndihmojmë shkollat e mesme të larta sepse normale që për shkollat e ciklit të ulët tekstet shkollore janë falas që është obligative për regjistrimin e fëmijëve që nga para shkollorët dhe tani është cikli i ulët deri në klasën e IX-të, ndërsa cikli i lartë fillon nga klasa e X-të dhe çdo herë ne kemi intervenuar në bashkëpunim dhe koordinim të mirë dhe do të ju ndihmojmë edhe më shumë edhe komunitetit jo shumicë që të regjistrohen në shkollat e mesme të larta, dhe këtë Komuna jonë e ka pas si praktikë që të mos e anashkalojmë asnjë nxënës i cili ka dëshirë ta vazhdojë shkollimin.

Arsyeja ka qenë e thjeshtë, edhe pse nuk ka qenë obligative por është e vullnetit të mirë nga institucionet komunale që të gjithë, pa përjashtim, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në këtë proces, pra si Komuna që jemi dhe i referohem edhe organeve më të larta sepse kam edhe takime që mbaj për këtë, dhe Komuna jonë ka qenë e veçantë që i'u ka ndihmuar nxënësve që kanë qenë të regjistruar në shkollat e mesme të larta e që nuk ka pasur mundësi që t'i blejnë tekstet shkollore, por që Komuna çdo herë ka ndarë një buxhet me qëllim të t'i ndihmojë ata nxënës, mirëpo në kuadër të këtij buxheti kanë përfituar edhe nxënësit e komunitetit shumicë, pra kryesisht ka të bëjë me ata me gjendje të rëndë sociale që ballafaqohen ato familje dhe dihet që kostoja nuk është aq e lehtë sepse një familje mund t'i ketë 3-4 nxënës, dhe është normale që të ketë kosto më të madhe, pra ne me këtë e kemi arritur ta bëjmë një stabilizim në kuptimin pozitiv ku kanë përfituar edhe komuniteti shumicë të cilët nuk i kanë pas mundësitë ekonomike, por gjithashtu edhe komuniteti jo shumicë, pra të gjitha familjet të cilat janë në një gjendje jo të mirë financiare ekonomike i kemi ndihmuar dhe sa do pak i lehtëson vështirësitë e këtyre familjeve ku i'u largohet një barrë ekonomike do ta quaja ashtu. Unë e them që Komuna është e gatshme dhe çdo herë ka qenë e gatshme dhe unë sërish do të flas me drejtorin e DKA-së që së paku ato familje që nuk i kanë mundësitë t'iu ndihmohet në kuptimin material me atë buxhet që ka, arsyeja është shumë e thjeshtë ku të gjithë ne duhet të angazhohem që t'iu ndihmojmë më shumë familjeve që janë në nevojë, por normale që ky si Komitet për Komunitete kërkon më shumë për ato familje të komunitetit jo shumicë edhe pse në këtë kontest nuk dua të bëjë ndarje por që esenciale është që ata nxënës të shkojnë në shkollë dhe të avancohen sepse avancimi i tyre në shkollim është e mirë për të gjithë qytetarët. Kjo është natyrë e jona që e kemi aplikuar çdo herë dhe aplikojmë që gjithmonë të jemi pranë qytetarëve dhe sidomos për shkollat dhe nxënësit që e kemi edhe obligim dhe duhet t'i përkrahim me ato mundësi që i kemi.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, faleminderit i nderuar zotëri Zeqiri për këto gjëra që i theksoi sepse vërtetë po preken shumë çështje por çështja kryesore të arsimit është që komuniteti jo shumicë gjithmonë ka ecë përpara me arsim dhe nëse nuk ka arsim natyrisht se komuniteti jo shumicë mbetet mbrapa pastaj, mirëpo fal interesimit të pjesëtarëve të komunitetit jo shumicë, Komunës, pastaj me bursa të ndryshme, si komunitet jo shumicë kemi arritur që të gjithë ata nxënës që e përfundojnë shkollën fillore tani po regjistrohen në shkollat e mesme, pra nuk kemi mos regjistrim në shkollat e mesme, përjashtim tani në këtë vit është lajmëruar një rast por që pas përfundimit të afatit për regjistrim ai nxënës është regjistruar, kështu që i falënderoj të gjithë drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme që kanë interesim për nxënësit e komunitetit jo shumicë gjatë regjistrimit.

znj. Fikmete Qurkolli, theksoi, përshëndetje për të gjithë, unë i propozoj Drejtorisë së Arsimit që në klasë të I-së të mos e regjistrojnë vetëm një fëmijë të komunitetit në një klasë, meqenëse ai fëmijë pastaj po abuzohet dhe kur po vije momenti i fundit po e lë shkollën në klasë të VI-të ose në klasë të VIII-të, e them këtë sepse kemi një rast ku një është femër kur e ka lënë mësimin në klasë të VIII-të dhe ka kërkuar nga drejtorja e shkollës që të kalojë në një klasë tjetër me qëllim të

përfundimit të shkollës fillore, nuk i është mundësuar kalimi dhe pas kësaj ajo e ka lënë shkollën, dhe përveç kësaj edhe prindi i saj ka bërë kërkesë që t'i ndërrohet klasa asaj nxënëse por që nuk është mundësuar sërish transferimi e që pas kësaj e njëjta e ka lënë shkollën.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, si e ka emrin vajza për të cilën fole dhe në cilën shkollë ka qenë.

znj.Fikmete Qurkolli, duke i'u përgjigjur Kryesuesit, theksoi, sa i përket emrit tani nuk mund ta them emrin e saj, por krejt çka mund të them është se e ka lënë shkollimin në klasë të IX-të, gjë kjo e cila është shumë keq për mendimin tim sepse po ju shkelen të drejtat vajzave.

Kryesuesi i Komitetit, sërish lidhur me çështjen në fjalë, theksoi, ne mund të bëjmë përpjekje dhe me shumë gjasë ta regjistrojmë prapë atë vajzë nëse është e interesuar.

znj.Fikmete Qurkolli, theksoi, nuk mund ta regjistrojmë sepse ajo tani në këtë kohë është dashtë të jetë në klasë të X-të, e që kur e ka ndërprerë klasën fillore në të mesmen nuk dëshiron të shkoj.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, lidhur me këtë rast që e përmendi parafolësja, unë nuk kam qenë i informuar, tash po e dëgjoj këtë problem, këtë çështje shumë lehtë do ta zgjidhja, por nuk e kam ditur, dhe në një formë mund të them se faji është te ju që nuk keni treguar për këtë problem.

znj.Fikmete Qurkolli, theksoi, për rastin në fjalë edhe unë tash e kam marr vesh sepse ajo vajzë ka dashtë që të shkoj në shkollë por nuk e kanë lejuar që ta ndërrohet klasën dhe pastaj e ka lënë shkollën për shkak që e kanë abuzuar.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, unë me të gjitha shkollat dhe gjithë sekretarët e shkollave që kam biseduar kam kërkuar që nxënësit e komunitetit jo shumicë të mos jenë në një klasë të gjithë por të jenë nga dy tre apo katër, sepse po të jenë të gjithë në një klasë nuk do të ishte mirë. Tash në projektin e fundit që është mbajtur me një Organizatë, nxënësit e komunitetit jo shumicë kanë shkuar së bashku dhe kemi pasur një sukses shumë të mirë gjatë këtyre muajve verorë, ndërsa te rasti në fjalë nuk po e shoh të arsyeshme që të përfundoj shkollën për këtë arsyeje.

z.Liman Zeqiri, theksoi, ajo fjalë që u citua ma herët këtu nuk ishte e mirë, pra ishte e vrazhdë për mua, sepse nuk ka ndarje në shkolla, mund t'ju them se më 08.04.2025 unë së bashku me Kryesuesin e këtij Komiteti i kemi vizituar shkollat "Naim Frashëri", "Shaban Shala" ku i kemi marrë informacionet për ata që e kanë ndërprerë mësimin për shkaqe ekonomike apo familjare, por nuk është prezantuar çështja e asaj nxënëseje që ka të bëjë me abuzim, sepse ky term abuzim është jo fjalë adekuate, jo mirë dhe jo e shëndetshme dhe nuk qëndron sikurse që nuk qëndron as bullizimi, dhe nuk është ajo tema që është vetëm në klasë dhe ka dëshiruar ta ndërroj klasën e të shkoj ku ka nxënës më shumë të komunitetit jo shumicë, përkundrazi është mirë që të bëjmë një praktikë tjetër ku nxënësit e komunitetit jo shumicë shkojnë në klasa ku ka nxënës të komuniteti shumicë sepse ne nuk mund të ndahemi, shkollat dhe klasat nuk ndahet por as fëmija nuk mund të ndahet, aty nuk ka ngjyrë, fe dhe ideologji, aty janë nxënës të gjithë të njëjtë dhe janë të mirëseardhur, nuk ka fuqi në botë që mund të thotë pse je ti ose ai ose tjetri, sepse shkolla është e përbashkët dhe është institucion i dijes, këtu nuk ka ndarje, andaj ju lutem nuk bënë që të përdoren terma të tillë sepse nuk janë të mira për Komunën tonë. Sepse këtu nuk ka as abuzim e as bullizim. Ne e dimë që kemi intervenuar në shumë familje që e kanë ndaluar procesin mësimor qoftë në klasën e VIII-të, VII-të e IX-të, kemi edhe raste për arsyeje sociale-ekonomike apo familjare që është dashtë të ndihmojmë ndonjë anëtarë të familjes, megjithatë është komisioni në kuadër të shkollave që është për parandalimin e braktisjes së nxënësve nga shkollimi sepse është cikli që gjithashtu jep përgjegjësi edhe prindi, por është edhe komisioni i veçantë në kuadër të DKA-së ku së bashku me z.Xhafer Ademin jemi anëtar në atë komision për parandalimin e ndërprerjes së shkollimit, dhe në kuadër të kësaj ne kemi detyrë dhe obligim që të shkojmë nëpër familje, shkolla dhe drejtori për tu informuar me gjendjen reale, t'i kuptojmë arsyet dhe shkaqet pse ndonjë nxënës/e e ka ndërprerë mësimin, andaj nuk duhet të thuhet në këtë mënyrë që është abuzuar.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, gjatë fjalimit tuaj i nderuar zotëri Zeqiri më kujtove vizitën që kemi bërë në shkollë dhe aty jam informuar që dy nxënës të komunitetit jo shumicë e kanë ndërprerë mësimin, ku njëra e ka lënë mësimin për arsyeje që prindi i saj ka vendosur që ajo të lë shkollën, ndërsa rasti tjetër është që vajza herë ka shkuar herë nuk ka shkuar në shkollë dhe ka qenë e gatshme për të braktisur shkollën. Pastaj nga momenti që kam dal nga ajo vizitë në shkollë kam shkuar te prindi i asaj vajze dhe e kam bindur të vazhdoj shkollimin sepse ajo vajzë ka qenë në klasë të X-të dhe pastaj ka vazhduar shkollën deri në përfundimin të saj, por nuk e ka vazhduar mandej shkollimin e mesëm, ndërsa rasti tjetër ka qenë që prindi i vajzës nuk ka qenë në dijeni për mungesat e saj, mirëpo tani edhe ajo vajzë e ka vazhduar mësimin.

Përveç këtyre, është edhe një rast ku një vajzë po ashtu e komunitetit jo shumicë e ka ndërprerë mësimin edhe pse jemi takuar me prindër të saj dhe me të gjithë por nuk kemi arritur ta bindim të kthehet në shkollë. Ndërsa lidhur me rastin e cekur sot që paska ndodhur ashtu, nëse vërtetë qëndron ashtu siç u tha, mua më vie keq sepse unë nuk e kam ditë, dhe tash u njoftova për atë rast.

3. Caktimi i datave për vizitat në shkollat fillore të mesme të ulëta në fshatrat Sfeçël-Batlavë dhe Orllan.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë tani sa ka filluar viti i ri shkollor dhe nuk besoj që mund t'i vizitojmë këto shkolla sipas planifikimeve mendoj se është mirë t'i lëm për më vonë këto vizita në qoftë se veç kemi mundësi dhe mund të organizohemi, kjo për shkak se ende nxënësit janë duke u regjistruar dhe nuk kemi statistika për këto shkolla, kështu që nuk mund të marrim shënime të sakta, andaj mendoj se do të ishte mirë të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës për një datë tjetër.

Njëzëri me 9 vota Për, mbështetet propozimi i Kryesuesit të Komitetit për shtyrjen e kësaj pike të rendit të ditës për një datë tjetër me arsyetimin se meqë jemi në fillim vit shkollor dhe ende është duke vazhduar regjistrimi i nxënësve dhe çështje tjera rreth mbarëvajtjes së procesit të fillimit të vitit të ri shkollor e që ende nuk ka statistike e as raporte të sakta.

4. Të ndryshme

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, po besoj që ky është takimi i fundit i joni si Komiteti për Komunitete i këtij mandati dhe kësaj legjislature ngase siç jemi në dijeni tashmë jemi në fushat zgjedhore për zgjedhjet lokale dhe nuk besoj që mund të mbajmë më ndonjë mbledhje të Komitetit, unë si përfaqësues dhe Kryesues i këtij Komiteti, Planin që e kemi pas deri më tani konsideroj se e kemi realizuar, dhe atë mund të them 98%.

Dua të falënderoj Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, e në veçanti shefin e kësaj zyre z.Liman Zeqiri i cili ka qenë shumë aktiv dhe na ka ndihmuar shumë si Komitet në çdo aspekt lidhur me Planet tona që kemi pasur. Gjithashtu falënderoj Zyrën Ligjore që na ka ndihmuar shumë lidhur me çështjet ligjore, organizmin dhe mbajtjen e mbledhjeve si dhe çështje tjera qoftë praktike, profesionale e teknike. Po ashtu falënderoj edhe anëtarët e Kuvendit të Komunës që janë edhe pjesë e këtij Komiteti të cilët kanë marr pjesë në takimet tona dhe na kanë ndihmuar në projektet të cilat i kemi pasur gjatë këtij mandati. Falënderim tjetër shkon edhe për Policinë e Kosovës e cila gjithmonë ka qenë këtu pran neve dhe ka qenë në dijeni për brengat dhe problemet e komunitetit jo shumicë wqë jeton në Komunën e Podujevës. Po ashtu falënderim tjetër shkon edhe për OSBE-në e cila ka marr pjesë gjithmonë në takimet tona dhe është konsultuar me neve

për problemet dhe projektet që i kemi pas. Mandej falënderoj edhe UNMIK-un, e në veçanti KFOR-in që gjithmonë ka qenë këtu me neve dhe është interesuar për problemet tona, ku edhe jashtë mbledhjeve kemi pasur takime në interes të komunitetit jo shumicë. Në fund falënderoj edhe anëtarët e Komitetit për Komunitete nga radhët e komunitetit Rom Ashkali dhe Egjiptas të cilët kanë kontribuar dhe na kanë ndihmuar lidhur me problemet e komunitetit jo shumicë e që i kemi realizuar aq sa kemi pasur mundësi t'i zgjedhim. Pra edhe një herë falënderoj të gjithë për ndihmën dhe me këtë po e përfundojmë këtë mbledhje dhe këtë mandat të kësaj legjislature si Komitet për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

z.Liman Zeqiri, theksoi, edhe unë si shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim e kam një falënderim të posaçëm për të gjithë juve që jeni anëtarë të Komitetit për Komunitete, por unë falënderimin më të madh e kam ndaj institucioneve komunale që çdo herë kanë pasur një përkrahje sepse mos të ishin të gjitha këto dikastere nuk do të kishim edhe informata të sakta për çdo temë që kemi ngritur këtu qoftë për arsim, shëndetësi, strehim, infrastrukturë, sport, kulturë dhe të gjitha fushat tjera, ku unë jam shumë falënderues për të gjithë ata që kanë jep kontribut për zgjedhjen e problemeve dhe interesave të komuniteteve jo shumicë në komunën e Podujevës.

Është normale që kjo këtu përfundon si proces i këtij mandati, por procesi nuk ndalet dhe çdo herë nuk është idealja që mund të themi sepse çdo herë është e mirë, e dimë të gjithë që ka sfida, probleme dhe çështje tjera që së bashku mund t'i zgjedhim dhe mund t'i kalojmë bashkërisht si shoqëri dhe bashkëpunimi në Komunën tonë është shumë i mirë.

Gjithashtu i falënderoj edhe Organizatat Ndërkombëtare që na ka ndihmuar shumë siç IOM dhe të tjerat, Po ashtu KFOR-in, Policinë që gjithmonë kanë qenë pranë neve si dhe të gjithë ata që kanë qenë aktiv dhe na kanë ndihmuar për problemet tona dhe mendojmë që edhe në të ardhmen do ta kemi përkrahjen e tyre dhe do të jemi ata që do t'i mbajmë barrën, por barrën kryesore do ta ketë Kryesuesi i Komitetit për Komunitete që duhet të sfidohet, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim sepse nganjëherë nuk mund t'i realizojmë të gjithë kërkesat, mirëpo megjithatë të gjithë së bashku mundohemi që t'ia dalim.

Pra nuk mund të themi se janë realizuar të gjitha ato kërkesa, ka ende punë, sfida dhe probleme por të gjithë së bashku mund të ia dalim.

Për fund, unë ju falënderoj të gjithë juve edhe ndoshta shihemi edhe takimeve tjera, por tashmë është fushatë zgjedhore, do të vijë asambleja e re, por unë jam shumë falënderues ndaj jush për bashkëpunimin e juaj në të gjitha fushat që i kemi pasur.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, po ashtu edhe unë falënderoj të gjitha Drejtoritë e Komunës që kanë marr pjesë në takime dhe na janë përgjigjur gjatë takimeve tona, dhe gjithashtu falënderime të veçanta për Kryetarin e Komunës që gjithmonë na ka përkrah gjatë gjithë kohës.

Meqë nuk kishte të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komiteti e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje dhe këtë mandat të kësaj legjislature të VII-të të Kuvendit të Komunës së Podujevës respektivisht Komitetit për Komunitete.

Mbledhja përfundoi në orën 10:38

**Procesverbalin e mbajti,
Arbrim Idrizi**

**Nr.Prot.01-060/04-0058214/25
Podujevë, 08 shtator 2025**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**